



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-365

24.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pikat 6 dhe 10 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të arritshme për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin nr.02-4325/6 datë 23.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer të dispozitave nga neni 14 i Ligjit për media (LM), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit të tij programor transmetuar më 9 gusht 2023, në pjesë të programeve të transmetuar nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor në veçanti.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për media (LM), është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara me nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përckatuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individualisht të përmbajtjes (për shembull kopje e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme: emërtim dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, respektivisht të

redaktorëve në pajtueshmëri me organizim e brendësh të redaksisë dhe emërtim dhe adresë të shtypshkronjës dhe datën e botimit (shtypjes) ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të botuara (shtypura), kur kemi të bëjmë me media të shtypit. Për transmetuesit e lartpërmendur detyrimi zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim dhe në fund të programeve audio/udiovizive. Botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo përmbajtje t'i publikon të dhënat e mëposhtme: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës (bashkëngjitjes) së publikuar, emri dhe mbiemri i personit, respektivisht të firmës bartës të së drejtës autoriale të përmbajtjeve të publikuara, përveç në mediat e shkruara dhe programeve në radio, datën e produksionit (muaj dhe vitin) kur kemi të bëjmë me vepër audio/udiovizive, origjina e veprës audio/udiovizive, dhe nëse vepra është prodhuar nga produksion i pavarur dhe informacion për të, emrin e personit juridik, respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit që e ruan të mirën e përdorur kulturore ose vepër arkivore, respektivisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga ku është marrë bashkëngjitja (shtojca) e programit ose fragment nga shtojca e programit, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, në programet e tjera me prodhim vendor, impresium publikohet në këtë mënyrë: në shpicën lajmëruese dhe çajmëruese publikohen të dhënat në vijim: emrin dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emrin dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka); emrin dhe mbiemrin e redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emrin dhe mbiemrin e kan-autorit, respektivisht të të gjithë ekipit realizues pjesëmarrës në tërësinë e veprës audiovizuale; emërtimi i subjekteve që kanë prodhuar programin (të vetë transmetuesit, koproducentëve, producentit të pavarur nga ku është porositur programi) dhe data e produksionit (muaj dhe vitin). Nëse është e zbatueshme, duhet të publikohen dhe të dhënat për: emrin e personit juridik, respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit që e ruan të mirën e përdorur kulturore ose veprën arkivore, respektivisht reproduksionin e veprës dhe emrin e subjekti tjetër nga ku është marrë shtojca e caktuar ose pjesë nga shtojca, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pikën 10 nga Udhëzimi i cituar është parashikuar që kur transmetohen programe nga prodhim i huaj, televizioni duhet të transmetojë shpicën origjinale.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 9 gusht 2023 nga ku u konstatua shkelja e nenit 14 të LM. Gjegjësisht, me mbikëqyrjen është konstatua se në pjesë nga programi i transmetuar më 9 gusht 2023, nuk janë publikuar të dhënat që indentifikojnë autorët pjesëmarrës në përgatitjen e përmbajtjeve audiovizuale, për bartësit e të drejtave autoriale, për redaktorin përgjegjës/redaktorët e programeve, për origjinën dhe për datën e produksionit të veprave audiovizuale, emrin e mediumit nga ku është ndërmarrë përmbajtja. Në kundërshtim me pikat 6 (impresium për programe nga prodhim vendor) dhe 10 (impresium për programe nga prodhim i huaj) të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, pa impresium janë transmetuar: „Trojca braqa (Tre vëllezërit) – Përadha popullore maqedonase“ – programi artistik dhe Promovimi i librit „Thesaret e Artit Kërçovar“ nga Vaid Nasufi – emisioni informativ nga fusha e artit. Këto janë të dhëna që transmetuesi është i obliguar t'i transmeton në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar sipas datës, emërtimit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillim dhe mbarim) dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencis drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, më 06.09.2023 ka dërguar Shkresë me Nr.y në ark.10-3352/2 datë 06.09.2023 me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 29.09.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptoi masën – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pikat 6 dhe 10 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimit për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrativ ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/6 datë 23.11.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1. të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendim, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-3352/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.